



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 187

Tiranë – E premte, 22 dhjetor 2023

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 94/2023, datë 7.12.2023	Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 22321
Dekret i Presidentit nr. 371, datë 20.12.2023	Për shpallje ligji..... 22327
Ligj nr. 95/2023 datë 7.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 22327
Dekret i Presidentit nr. 372, datë 20.12.2023	Për shpallje ligji..... 22331
Ligj nr. 96/2023, datë 7.12.2023	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 22331
Dekret i Presidentit nr. 373, datë 20.12.2023	Për shpallje ligji..... 22332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 20.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 446, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit”..... 22332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 20.12.2023	Për kalimin në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës të një pjese të pasurisë nr. 4/5-ND, zona kadastrale 2282, Krumë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 22334
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 20.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 662, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimet të ‘Unazës së Madhe’ Tiranë nga ‘Sheshi Shqiponja’ – ‘Bulevardi i Ri’ dhe ‘Rikualifikimi i ‘Unazës Lindore’ për lotet 4, 5, 6’”, të ndryshuar..... 22336

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 20.12.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i përroit, Lushnjë, dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, Bashkia Lushnjë.....	22339
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 20.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 778, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë arë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘By-Pass Plepa–Kavajë–Rrogzhinë, lotet 9, 10, 11 e 12’” .....	22342
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 20.12.2023	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Fierit.....	22345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 20.12.2023	Për mënyrën e administrimit të fondeve dhe qëndrimit në një territor të caktuar të shtetasve të huaj, të urdhëruar për të qëndruar në një territor të caktuar.....	22345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 20.12.2023	Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	22346
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 20.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar.....	22357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 20.12.2023	Për përcaktimin e rregullave dhe të autoritetit kompetent, për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).....	22357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 20.12.2023	Për shfuqizimin e vendimit nr. 581, datë 31.8.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor, për të ndërmarrë procedurat, për dhënien me koncesion/PPP, për projektin ‘Për ofrimin e shërbimit të infrastrukturës së çelësave publike (PKI)’”.....	22358
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 20.12.2023	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008.....	22358
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 20.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë” .....	22361

**LIGJ**  
**Nr. 94/2023****PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**  
**NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT**  
**NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 18, “Mënyra e llogaritjes”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Akciza e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni indekskohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT-i, por jo më

shumë se 1.5%, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij për të cilat akciza do të aplikohet sipas kalendarit të përcaktuar në shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet ligjit.

Indeksi i akcizës, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, është shuma e normës së shpallur të inflacionit të vitit të dytë paraardhës plus normën e shpallur të inflacionit që rezulton deri në fund të 9-mujorit të vitit paraardhës, por jo më shumë se 1.5%.”.

**Neni 2**

Shtojca nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 3**

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2024.

Miraturar në datën 7.12.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 371, datë 20.12.2023,**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bajram Begaj**

**SHTOJCA NR. 1****MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

<b>Kategoria</b>	<b>Kodi NK</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shkalla e taksimit</b>
<b>I. KAFE</b>			
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	62.9 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	52.4 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	262.1 lekë/kg kafe
<b>II. BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE</b>			
B000 Birra	22 03	Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%	744.4 lekë/HL/shkallë alkoolometrike



<p>W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara</p>	<p>22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89</p>	<p>Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara.</p> <p>- nga prodhues vendas e të huaj me sasi &lt; = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi &gt; 10 000 hektolitër/vit</p>	<p>- 3145.5 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë; dhe - 4194.0 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë</p> <p>- 10485.0 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë; dhe - 12581.9 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë</p>
<p>W300 Vera spumante, shampanja dhe pije të fermentuara dhe të gazuara</p>	<p>22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81</p>	<p>Verërat spumante, shampanja; verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë” që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak.</p> <p>Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara. Cider dhe cider dardhe me përmbajtje alkooli 8,5%</p>	<p>5452.2 lekë/HL</p> <p>3271.3 lekë/HL</p>
<p>I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme</p>	<p>22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90</p>	<p>Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum, por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.</p>	<p>5452.2 lekë/HL</p>



	22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89		
S200 Pije alkoolike ( <i>Spirituous Beverages</i> )	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993 22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22082088 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, <i>Whisky</i> ,  Rum dhe pije të tjera të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva,  Vodka, likere dhe tonikë, uzo.	88597.8 lekë për HL alkool anhidër
	22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011		



	22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033		
S300 Alkooli etilik jo i denatruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	47182.3 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denatruar	22072000	Alkool etilik i denatruar	0 (zero)
S400 Rakia, sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082028	Raki	20969.9 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2% ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	47182.3 lekë për HL alkool anhidër
<b>III. DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ</b>			
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan (lek/kg)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7000 lekë/kg më 1 janar 2023; 7250 lekë/kg më 1 janar 2024; 7500 lekë/kg më 1 janar 2025; 7750 lekë/kg më 1 janar 2026.
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan (lek/fije cigare)	6750 lekë/1000 fije më 1 janar 2022; 7000 lekë/1000 fije më 1 janar 2023; 7250 lekë/1000 fije më 1 janar 2024; 7500 lekë/1000 fije më 1 janar 2025; 7750 lekë/1000 fije më 1 janar 2026.
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani (lek/kg)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7000 lekë/kg më 1 janar 2023; 7250 lekë/kg më 1 janar 2024; 7500 lekë/kg më 1 janar 2025; 7750 lekë/kg më 1 janar 2026.
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit, duhan me dredhje (lek/kg)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7000 lekë/kg më 1 janar 2023; 7250 lekë/kg më 1 janar 2024; 7500 lekë/kg më 1 janar 2025; 7750 lekë/kg më 1 janar 2026.
		Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lek/kg)	2750 lekë/kg më 1 janar 2022; 3000 lekë/kg më 1 janar 2023; 3250 lekë/kg më 1 janar 2024; 3500 lekë/kg më 1 janar 2025; 3750 lekë/kg më 1 janar 2026.
T401 Nikotinë	2404 12	Produktet që përmbajnë nikotinë lëng (lek/ml)	12 lekë/ml më 1 janar 2022 14 lekë/ml më 1 janar 2023 16 lekë/ml më 1 janar 2024 18 lekë/ml më 1 janar 2025 20 lekë/ml më 1 janar 2026
	24 04 91	Produkte duhani për përdorim oral (lek/kg)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7250 lekë/kg më 1 janar 2023; 7750 lekë/kg më 1 janar 2024; 8250 lekë/kg më 1 janar 2025;



			8750 lekë/kg më 1 janar 2026.
T402 Duhan me ngrohje	24 04 11	Duhan me ngrohje, pa djegie (lek/kg)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7250 lekë/kg më 1 janar 2023; 7750 lekë/kg më 1 janar 2024; 8250 lekë/kg më 1 janar 2025; 8750 lekë/kg më 1 janar 2026
T403 Shisha, nargjile	24 03 11	Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) (lek/kg duhan në produkt)	6750 lekë/kg më 1 janar 2022; 7250 lekë/kg më 1 janar 2023; 7750 lekë/kg më 1 janar 2024; 8250 lekë/kg më 1 janar 2025; 8750 lekë/kg më 1 janar 2026
		Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lek/kg duhan në produkt)	2750 lekë/kg më 1 janar 2022; 3000 lekë/kg më 1 janar 2023; 3250 lekë/kg më 1 janar 2024; 3500 lekë/kg më 1 janar 2025; 3750 lekë/kg më 1 janar 2026.
<b>IV. PRODUKTET ENERGJETIKE</b>			
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krrerët 1507 deri 1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E201 Qymyri	2701	Qymyr; briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuar prej qymyrit	0 lek/kg
E202 Linjiti	2702	Linjit, nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi	0 lek/kg
E203 Koks dhe gjysmë koks	2704	Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit, linjtit apo prej torfe, nëse është apo jo i aglomeruar; karbon i konvertuar	0 lek/kg
E204 Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi	2705	Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi dhe gazra të tjera të ngjashme, përveç gazrave të naftës dhe hidrokarbureve të tjera gazoike	0 lek/kg
E205 Katran i distiluar nga qymyri	2706	Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katrane të tjera minerale, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluara, përfshirë katranet e rindërtuara	0 lek/kg
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që u përkasin kodeve NK të kreut 2707	52.4 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	52.4 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përbajtje plumbi jo më tepër se	38.8 lekë/litri



		0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	52.4 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	21.0 lekë/litri 21.0 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	38.8 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	38.8 lekë/kg
E460	27 10 20	Biodiesel me vajra nafte	38.8 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	41.9 lekë/kg
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5.2 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	41.9 lekë/kg
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2.1 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5.2 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5.2 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumin e naftës, në katranin mineral ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh. asfalto-beton)	5.2 lekë/kg bitum
E492	27 14 90 00	Zhavorr bituminoz	0.3 lekë/kg
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh.  Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	6.3 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	38.8 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	38.8 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli)	29051100	Metanol (alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit





metilik)			
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	41.9 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimevetë neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	38.8 lekë/litri
<b>V. FISHEKZJARRËT</b>			
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	209.7 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	209.7 lekë/kg
<b>VI.GOMAT</b>			
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	21.0 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	41.9 lekë/kg

**DEKRET**

Nr. 371, datë 20.12.2023

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 94/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

**Bajram Begaj**

**LIGJ**

Nr. 95/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,  
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,  
TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2013/34, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Mbi pasqyrat vjetore financiare, pasqyrat e konsoliduara financiare dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve”, që ndryshon direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe

83/349/KEE, e ndryshuar. Numri CELEX 32013L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 182, datë 29.6.2013, faqe 19–76.



## Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit:

- a) fjalët “tatimit/n mbi fitimin” zëvendësohen me fjalët “tatimit/n mbi fitimin korporativ”;
- b) fjalët “tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi”.

## Neni 2

Pas seksionit IV, të kreut VI, “Mbajtja e të dhënave”, shtohet seksioni V, “Raporti për çdo vend”, me këtë përmbajtje:

**“Seksioni V  
Raporti për çdo vend**

## Neni 63/1

**Terminologjia bazë për raportin për çdo vend**

Për qëllime të neneve 63/2 deri 63/6 dhe 115/4 të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Grup” është një bashkësi entitetesh të lidhura nëpërmjet pronësisë ose kontrollit, në mënyrë të tillë që kërkohet të përgatiten pasqyrat financiare të konsoliduara për qëllime të raportimit financiar, sipas parimeve të zbatueshme të kontabilitetit, ose do të kërkoheshin nëse interesat e kapitalit të ndonjë prej entiteteve do të tregtoheshin në një bursë publike të letrave me vlerë;

b) “Grup shoqërie shumëkombëshe” është çdo grup që:

i. përfshin dy ose më shumë entitete, rezidenca tatimore e të cilave është në juridiksione të ndryshme ose përfshin një entitet që është rezident për qëllime tatimore në një juridiksion dhe i nënshtrohet tatimit në lidhje me biznesin e kryer nëpërmjet një selie të përhershme në një juridiksion tjetër; dhe

ii. nuk është një grup shoqërie shumëkombëshe i përjashtuar;

c) “Grup shoqërie shumëkombëshe i përjashtuar” është një grup që ka të ardhura totale të konsoliduara të grupit më pak se 105 000 000 000 (njëqind e pesë miliardë) lekë gjatë vitit fiskal pararendës të vitit fiskal raportues, siç pasqyrohet në pasqyrat financiare të konsoliduara për atë vit fiskal;

ç) “Entitet përbërës” është:

i. çdo njësi e veçantë biznesi e një grupi shoqërie shumëkombëshe, që përfshihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit të shoqërive shumëkombëshe për qëllime të raportimit financiar ose do të përfshihej nëse interesat e kapitalit të një njësie të tillë biznesi janë tregtuar në një bursë publike të letrave me vlerë;

ii. çdo njësi biznesi që përjashtohet nga pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit të shoqërive shumëkombëshe vetëm për arsye të madhësisë ose të materialitetit; dhe

iii. çdo seli e përhershme e ndonjë njësie të veçantë biznesi të grupit të shoqërive shumëkombëshe të përfshirë në nënndarjet “i” ose “ii” të kësaj shkronje, me kushtin që njësia e biznesit të përgatisë një pasqyrë financiare të veçantë për një seli të tillë të përhershme për qëllime të raportimit financiar, raportimit në përputhje me legjislacionin tatimor ose të kontrollit të menaxhimit të brendshëm;

d) “Entitet raportues” është entiteti përbërës, të cilit i kërkohet të paraqesë një raport për çdo vend, në përputhje me kërkesat e nenit 63/4 të këtij ligji, në juridiksionin e tij të rezidencës tatimore, në emër të grupit të shoqërive shumëkombëshe. Entiteti raportues është entiteti mëmë përfundimtar;

dh) “Entitet mëmë përfundimtar” është një entitet përbërës i një grupi shoqërie shumëkombëshe, që plotëson kriteret e mëposhtme:

i. zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë një interes të mjaftueshëm në një ose më shumë entitete të tjera përbërëse të një grupi shoqërie shumëkombëshe, në mënyrë të tillë që i kërkohet të përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara sipas parimeve të kontabilitetit, që zbatohen përgjithësisht në juridiksionin e tij të rezidencës tatimore, ose nëse interesat e tij të kapitalit janë tregtuar në një bursë publike të letrave me vlerë në juridiksionin e tij të rezidencës tatimore; dhe

ii. nuk ka asnjë entitet tjetër përbërës të grupit të shoqërive shumëkombëshe, që zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë një interes si ai i përshtuar në nënndarjen “i” të kësaj shkronje;

e) “Vit fiskal” është një periudhë kontabël vjetore për të cilën entiteti mëmë përfundimtar i grupit të shoqërive shumëkombëshe përgatit pasqyrat e tij financiare;

ë) “Vit fiskal raportues” është ai vit fiskal, rezultatet financiare dhe operacionale të të cilit



pasqyrohen në raportin për çdo vend të përcaktuar në nenin 63/4 të këtij ligji;

f) “Pasqyra financiare të konsoliduara” janë pasqyrat financiare të një grupi shoqërie shumëkombëshe në të cilën aktivet, pasivet, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të entitetit mëmë përfundimtar dhe të entiteteve përbërëse paraqiten si ato të një entiteti të vetëm.

Neni 63/2

#### **Detyrimi për dorëzimin e raportit për çdo vend**

Çdo entitet mëmë përfundimtar i një grupi shoqërie shumëkombëshe, që është rezident për qëllime tatimore në Republikën e Shqipërisë, paraqet një raport për çdo vend, në përputhje me kërkesat e nenit 63/4 të këtij ligji, në administratën tatimore të Republikës së Shqipërisë për vitin e tij fiskal raportues në ose përpara datës së përcaktuar në nenin 63/5 të këtij ligji.

Neni 63/3

#### **Njoftimi**

Çdo entitet përbërës, që është rezident për qëllime tatimore në Shqipëri, duhet të njoftojë administratën tatimore jo më vonë se dita e fundit e vitit fiskal raportues të grupit të shoqërive shumëkombëshe:

a) nëse është entiteti mëmë përfundimtar i grupit; ose

b) kur entiteti përbërës nuk është entiteti mëmë përfundimtar, të dhënat identifikuese dhe rezidencën tatimore të entitetit raportues.

Neni 63/4

#### **Raporti për çdo vend**

1. Raporti për çdo vend në lidhje me një grup shoqërie shumëkombëshe është një raport që përmban:

a) informacion lidhur me shumën e të ardhurave, fitimin (humbjen) përpara tatimit mbi të ardhurat, tatimin e paguar mbi të ardhurat, tatimin e përllogaritur mbi të ardhurat, kapitalin e deklaruar, fitimet e akumuluar, numrin e punonjësve dhe asetet e prekshme, përveç parasë *cash* ose

ekuivalentëve të saj, për çdo juridiksion në të cilin operon grupi i shoqërive shumëkombëshe;

b) një identifikim të çdo entiteti përbërës të grupit të shoqërive shumëkombëshe, që përcakton juridiksionin e rezidencës tatimore të entitetit përbërës dhe, kur është i ndryshëm nga juridiksioni i rezidencës tatimore, juridiksionin sipas ligjeve të të cilit është i organizuar entiteti përbërës dhe natyrën e aktivitetit ose aktiviteteve kryesore të biznesit të entitetit përbërës.

2. Procedurat dhe informacioni i detajuar që përmban raporti për çdo vend përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63/5

#### **Afati për dorëzim**

Raporti për çdo vend, sipas dispozitave të këtij ligji, dorëzohet jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas ditës së fundit të vitit fiskal raportues të grupit të shoqërive shumëkombëshe.

Neni 63/6

#### **Përdorimi dhe konfidencialiteti i informacionit të raportit për çdo vend**

1. Administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë përdor raportin për çdo vend për qëllime të vlerësimit të rreziqeve të nivelit të lartë për transferimin e çmimit dhe rreziqeve të tjera të lidhura me erozionin e bazës tatimore dhe zhvendosjen e fitimit në ose nga Republika e Shqipërisë, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të mosrespektimit nga anëtarët e grupit të shoqërive shumëkombëshe të rregullave të zbatueshme, lidhur me transferimin e çmimit dhe, kur është e përshtatshme, për analiza ekonomike dhe statistikore. Rregullimet e transferimit të çmimit nga administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë nuk bazohen në raportin për çdo vend.

2. Administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë ruan konfidencialitetin e informacionit që përmban raporti për çdo vend, të paktën në të njëjtën masë që do të zbatohet nëse një informacion i tillë do t'i jepej sipas dispozitave të konventës shumëpalëshe mbi ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet tatimore.”



## Neni 3

Në shkronjën “dh”, të pikës 2, të nenit 105/2, fjalët “zëvendës drejtorëve të përgjithshëm dhe koordinatorëve rajonalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” zëvendësohen me fjalët “drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe drejtorëve rajonalë tatimorë”.

## Neni 4

Në pikën 3, të nenit 109, fjalët “dhe nuk apelohej prej tij” zëvendësohen me fjalët “brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data kur është marrë dëgjimi për këtë vendim”.

## Neni 5

Pas pikës 4, të nenit 111, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore nuk aplikohen dënimet administrative të parashikuara nga ky ligj në rastet kur mosdeklarimi në afat ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese apo zbatimit të një vendimi gjykatë të formës së prerë.”.

## Neni 6

Në fund të nenit 114/1, fjalët “10 për qind të shumës së kështit për t’u paguar plus kamatëvonesën e llogaritur për ditët e vonuara, por jo më shumë se 365 ditë.” zëvendësohen me fjalët “0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë kalendarike.”.

## Neni 7

Pas nenit 115/2, shtohen nenet 115/3 dhe 115/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 115/3

**Dënime lidhur me mosdërgimin e dokumentacionit për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë**

1. Dokumentacioni për zbatimin e dispozitave të marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë

dorëzohet brenda vitit kalendarik, që pason vitin në të cilin janë zbatuar dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Ky dokumentacion përcaktohet në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Nëse tatimpaguesi nuk e dorëzon dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë ndaj tatimpaguesit aplikohet një gjobë prej 10 000 lekësh për çdo muaj të paraqitjes me vonesë. Kjo gjobë aplikohet deri në 24 muaj pasues, pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Nëse tatimpaguesi nuk paraqet dokumentacionin edhe pas kalimit të afatit prej 24 muajsh të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, atëherë tatimpaguesi humbet të drejtën e zbatimit të dispozitave të marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe duhet të paguajë tatimet e papaguara apo pjesën e reduktuar të tatimit sipas marrëveshjes, si dhe gjobat dhe interesat për pagesë të vonuar në përputhje me këtë ligj.

Neni 115/4

**Dënime lidhur me detyrimet e raportimit për çdo vend**

1. Mospërmbushja e detyrimit për të dorëzuar në kohë raportimin për çdo vend, sipas dispozitave të këtij ligji, dënohet me gjobë 10 000 lekë për çdo muaj vonesë deri në 12 muaj pas afatit të përcaktuar në nenin 63/4 të këtij ligji.

2. Pas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për mospërmbushjen e detyrimit për paraqitjen e këtij raportimi tatimpaguesi dënohet me gjobë 200 000 lekë.

3. Mospërmbushja e detyrimit për paraqitjen e saktë dhe të plotë të raportimit për çdo vend, sipas dispozitave të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë.”.

Neni 8

Në nenin 123 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për tatimpaguesin, i cili për herë të dytë brenda vitit kalendarik kryen një shkelje sipas shkronjave “a” dhe/ose “c”, të pikës 1 të këtij neni, të konstatuar të dyja herët në kuadrin e një kontrolli tatimor “verifikim në vend”, përveç masës së gjobës,



siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, merren edhe masat e mëposhtme:

a) gjobë 50 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi, gjobë 100 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi me TVSH-në, gjobë 500 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin korporativ;

b) vlerësim tatimor për tre muajt e fundit duke përdorur metodat alternative të parashikuara në nenet 71 e 72 të këtij ligji për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në;

c) bllokimin e veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike.

Masa e bllokimit, sipas shkronjës “c” të kësaj pike, hiqet nëse tatimpaguesi paguan penalitetet e vendosura.”

Neni 9

Në shkronjën “b”, të nenit 125, fjalët “tatimin e thjeshtuar mbi fitimin,” zëvendësohen me fjalët “tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi;”.

Neni 10

#### **Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 11

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2024.

Miratuar në datën 7.12.2023

**Shpallur me dekretin nr. 372, datë 20.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

## **DEKRET**

**Nr. 372, datë 20.12.2023**

## **PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

## **DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 95/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

## **LIGJ**

**Nr. 96/2023**

## **PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

## **VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 6, të nenit 3, fjalët “për qymyrin (sipas krerëve të NKM-së 2701; 2702)” zëvendësohen me fjalët “për qymyrin (sipas krerëve të NKM-së 2701; 2702; 2704)”.

Neni 2

Pika 6, e nenit 4, ndryshohet si më poshtë:  
“6. Taksa e karbonit caktohet në masën:



- a) 1,5 lekë për litër për benzinën;  
b) 3 lekë për litër për gazoilin;  
c) për qymyrin:  
i. 4,5 lekë për kilogram nga data 1 korrik 2026;  
ii. 6.5 lekë për kilogram për vitin 2027;  
iii. 9 lekë për kilogram për vitin 2028;  
iv. 12 lekë për kilogram për vitin 2029;  
v. 15.3 lekë për kilogram për vitin 2030 dhe në vazhdim;  
ç) 3 lekë për litër për solarin;  
d) 3 lekë për litër për mazutin;  
dh) 3 lekë për litër për vajgurin;  
e) 3 lekë për kilogram për koks nafte.  
Kjo taksë nuk paguhet për sasi të benzinës e të gazoilit që eksportohen.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 7.12.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 373, datë 20.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

### DEKRET

Nr. 373, datë 20.12.2023

### PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

#### DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 96/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ‘Për taksat kombëtare’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

### VENDIM

Nr. 745, datë 20.12.2023

### PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 446, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE KALIBRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 446, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e listës së inventarit të pronave ta paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.”.

c) Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit, formulari për pronën, me emërtimin “DPMK dega Elbasan” zëvendësohet me formularin dhe planimetrinë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**



1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS


Identifikoi pronën: *Olavsala Hosi*  
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) *Pejti Shkël*

Institucioni Qendror Shtetëror: **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**  
 Istitucioni i Varsisë: **Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë**

Supervizori: *Arben Durrës*  
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) *DBN*

Aprovi: *Pejti Shkël*  
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, yll)

Nr. Rend	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Prones	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip.		funksioni për të cilin përdoret pronë pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni rrdorues i pasurisë Statusi juridik i perdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhena të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndertese (m2)					
1	ZK 8521	6/42-N	Njesi	Objekti i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ( Peshë matjes )Elbasan	45	0	45	Administratë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	VKM 446. 16.6.2005	





**VENDIM**  
**Nr. 746, datë 20.12.2023**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI  
 ADMINISTRIMI TEK AGJENCIA  
 SHETËTËRORE E KADASTRËS TË NJË  
 PJESE TË PASURISË NR. 4/5-ND, ZONA  
 KADASTRALE 2282, KRUMË, DHE PËR  
 NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.  
 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË  
 MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës të një pjese të

pasurisë nr. 4/5-ND, zona kadastrale 2282, Krumë, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ushtrimin e funksioneve administrative.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**


**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETËTËRORE**  
 (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Hartoi: Ing.Indrit MUJA <small>Indrit Muja</small> Miratoi: Fadil Mazrreku <small>Fadil Mazrreku</small> Instrukcioni qendror : Agjencia Shtetërore e Kadastrës Fusha e perdorimit te Prones: Administratë										
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2282 KR-C-3	Pjesë e Pasurise 4/5-ND	Njësi	Zyra Vendore ASHK Has	43.5m2	43.5m2	Administratë	Agjencia Shtetërore e Kadastrës	Zyra vendore ASHK Has	





**PLANIMETRIA E KATIT (II)  
OBJEKTI: ZV ASHK HAS**



Realizoi per ASHK  
Specialisti **Indrit Muja**

Indrit Muja  
Muja

*Digitally signed by Indrit Muja  
Date: 2023.08.17 09:27:14+0200*

**ZV ASHK HAS**  
Konfirmoi  
Pergjegjesi **Fadil Mazrreku**

Fadil Mazrreku

*Digitally signed by Fadil Mazrreku  
Date: 2023.08.17 10:49:27 +0200*

Objekti: **ZVASHK HAS**

**Sip.43.5 m<sup>2</sup>**

**GUSHT 2023**

**PLANIMETRIA  
Kati 2**

SH 1:100



Vulozur Elektronike Sh.p.a Zyra  
Vendore: Haxhi Mehmeti  
Date: 2023/08/17 11:31:14 +0200  
TPH:AS2023061711310828014

Shenim – Ky dokument është gjeneruar dhe vulozur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Zyra Vendore Has)

**VENDIM**

Nr. 748, datë 20.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE  
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 662,  
DATË 13.10.2022, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN,  
PËR INTERES PUBLIK, TË  
PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË  
PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR ‘RISHIKIMI I  
PROJEKTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR  
TË VAZHDIMIT TË ‘UNAZËS SË  
MADHE’ TIRANË NGA ‘SHESHI  
SHQIPONJA’ – ‘BULEVARDI I RI’ DHE  
‘RIKUALIFIKIMI I ‘UNAZËS LINDORE’  
PËR LOTET 4, 5, 6”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 662, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e

llojit “truall”, “tokë arë”, “ndërtesë”, “apartament”, “njësi” dhe “bodrum”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 172 860 230.6 (katër miliardë e njëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë pikë gjashtë) lekë.”.

b) Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej “3 851 711 841.5 (tre miliardë e tetëqind e pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e një pikë pesë) lekësh” zëvendësohet me “4 172 860 230.6 (katër miliardë e njëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë pikë gjashtë) lekë”.

ii. Në shkronjën “a”, vlera prej “3 729 003 342.5 (tre miliardë e shtatëqind e njëzet e nëntë milionë e tre mijë e treqind e dyzet e dy pikë pesë) lekësh” zëvendësohet me “4 050 151 731.6 (katër miliardë e pesëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e një pikë gjashtë) lekësh”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 662, DATË 13.10.2022, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RISHIKIMI I PROJEKTTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË ‘UNAZËS SË MADHE’ TIRANË NGA ‘SHESHI SHQIPONJA’ – ‘BULEVARDI I RI’ DHE ‘RIKUALIFIKIMI I ‘UNAZËS LINDORE’ PËR LOTET 4, 5, 6”, I NDRYSHUAR

Nr.	Emri	Aftësia	Mbiemri	TË DHËNAT E PASURISË			TOKË TRUALL				TOKË ARË			NDËRTESË SOC. EK.			OBJEKT BANIMI				VLERA totale (lek)	SHËNIME	
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësuar (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera lek	Sip. totale m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësuar (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera lekë	Sip. totale m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësuar (m <sup>2</sup> )	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësuar (m <sup>2</sup> )	Çmimi m <sup>2</sup>			Vlera lek
258	Ismet	Izet	Gruda	3976	136/545-ND	Ndërtesë									93.00	93.00	61,167.00	5,688,531.00	5,688,531.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë 136/545 vol 29 f.94 L.kg. Objekti banimi 1-katesh, Sip. e katit përbë = 93 m <sup>2</sup> . E. Kjo ndërtesë nuk ka marrëdhënie me truallin			
259	Dhurim	Rasim	Murati	3976	68/27	Arë						550.00	550	448	246,400.00					246,400.00	Konfirmuar nga ASHK-ja		
260	Xhevdet	Osman	Ruçi	3976	136/412	Truall	335.00	22.6	479.00	10,825.40										10,825.40	Konfirmuar nga ASHK-ja Kontratë për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës , sipas vlerave të kredisë		
261	Latif Anife	Agash Mehmet	Sarçi Sarçi	3976	136/392-nd	Ndërtesë	-								246.10	246.10	61,167.00	15,053,198.70	15,053,198.70	Konfirmuar nga ASHK-ja C. Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 136/392 vol. 21 f. 152 Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin			
262	Hasan	Sali	Kurti	3976	68/13	Arë						307.00	307	448	137,536.00					0.00	137,536.00	Konfirmuar nga ASHSH-ja Kontratë për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, sipas vlerave të kredisë	
263	Bekume Drita Mira Lumturije Edmond		Spajta Spajta Spajta Spajta	3976	68/15	Arë						1,380.00	324	448	145,152.00					0.00	145,152.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
264	Egërcem	Latif	Hasa	3976	35/6	Arë						410.00	410	448	183,680.00						183,680.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
265	Altin	Musa	Jahollari	3976	136/185	Truall+ndërtesë									148.00	148.00	61,167.00	9,052,716.00	9,052,716.00		Konfirmuar nga ASHK-ja		
266	Kastriot	Musa	Jahollari	3976	136/284	Truall+ndërtesë									164.00	164.00	61,167.00	10,031,388.00	10,031,388.00		Konfirmuar nga ASHK-ja		
267	Jonus	Musa	Jahollari	3976	136/283	Truall+ndërtesë	159.00	4.4	479.00	2,107.60					163.60	163.60	61,167.00	10,006,921.20	10,009,028.80		Konfirmuar nga ASHK-ja		
268	Yllion	Mete	Moraiti	2460	606/OND10	Ndërtesë									118.40	118.40	66,505.00	7,874,192.00	7,874,192.00		Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 606 vol. 5 f. 242 L. I.E.G. E. Vendoset hipotekë ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve për truallin		
269	Avdi	Hysen	Avdi	3976	18/ND1	Ndërtesë									143.80	143.80	61,167.00	8,795,814.60	8,795,814.60		Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin		
270	Tefa Maldin Armando	Hysen Aleksandër Aleksandër	Demko Demko Demko	3976	18/3-ND	Ndërtesë									219.40	219.40	61,167.00	13,420,039.80	13,420,039.80		Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin		
271	Illa	Shëne	Zheli	3976	35/52/ND	Ndërtesë									108.60	108.60	61,167.00	6,642,736.20	6,642,736.20		Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 35/52 vol 8 f. 112 E. Vendoset hipotekë ligjore deri në realizimin e marrëdhënieve me truallin		
272	Artur	Xhevair	Salla	1066	221/10	Ndërtesë									90.00	90.00	52,000.00	4,680,000.00	4,680,000.00		Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin		
273	Manjoja	Nesim	Haxhillari	1066	221/11	Ndërtesë									90.00	90.00	52,000.00	4,680,000.00	4,680,000.00		Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin		
274	Ylli Edisllata	Arif Admir	Prozilloni Prozilloni	1066	985/22	Truall+ndërtesë	168.6	97.8	3,560.00	348,168.00					56.20	56.20	52,000.00	2,922,400.00	3,270,568.00		Konfirmuar nga ASHK-ja		
275	Datim Afran	Ilkuran Datim	Pere Pere	8170	5/659	Truall	366.1	120	32,878.00	3,945,360.00										3,945,360.00	Konfirmuar nga ASHK-ja		
276	Serja Mehmet Nesti Ictmor	Ramadan Ramadan Ramadan	Peleshka Peleshka Peleshka	8170	5/485	Truall	434	35.9	32,878.00	1,180,320.20											1,180,320.20	Konfirmuar nga ASHK-ja	
277	Hysn	Refik	Sina	8170	5/215	Truall	174.9	49.7	32,878.00	1,634,036.60											1,634,036.60	Konfirmuar nga ASHK-ja	
278	Artan	Rahim	Kullolli	8170	3/1091	Truall	300	300	32,878.00	9,863,400.00											9,863,400.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
279	Vencitk	Servet	Sorra	8170	5/656	Truall	322	45.6	32,878.00	1,499,236.80											1,499,236.80	Konfirmuar nga ASHK-ja	
280	Idriz	Ramadan	Krasniqi	8120	3/15/ND	Ndërtesë									82.2	82.2	81,666.61	6,712,995.34	6,712,995.34		Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë ngrihet mbi pasurinë me nr. 3/15. E. Kufizohen veprimet deri në shlyerjen e detyrimeve për truallin		



281	Xhelal	Ymer	Hida	8120	3/18/ND	Ndërtesë											30	30	81,666.61	2,449,998.30	2,449,998.30	Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë sighehet mbi pasurinë me nr. 3/18 Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
282	Pashke Lindita Sokol Klodian	Prend Pashk Pashk Pashk	Luli Gjinaj Luli Luli	8310	11/204-ND	Ndërtesë											155.8	155.8	96,753.41	15,074,181.28	15,074,181.28	Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 11/204 vol. 32 f. 247, ZK 8310 titulli i pronësisë vendimi nr. 2738, datë 18.2.2022 për leg. e ndërtimit pa lejë ASHK-DVT Vet i vlefshëm vetëm për ndërtimin. Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
283	Prena	Lalash	Leraj	8310	10/272	Truall	183	183	31,219.00	5,713,077.00										0.00	5,713,077.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të pa ligjshëm	
284	Bilbil Llan	Llan	Lasku Lasku	8110	7/325	Truall+ndërtesë	414.1	223.8	23,703.00	5,304,731.40							359.9	359.9	60,959.00	21,939,144.10	27,243,875.50	Konfirmuar nga ASHK-ja	
285	Fahir Lulizam Limane	Skender Skender Jaap	Kamberaj Kamberaj Kamberaj	8110	5/589	Truall+ndërtesë	300	270.6	23,703.00	6,414,031.80							332.6	332.6	60,959.00	20,274,963.40	26,688,995.20	Konfirmuar nga ASHK-ja	
286	Lek	Gjergj	Fufi	8110	5/41-nd	Apartament											38	38	60,959.00	2,316,442.00	2,316,442.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Shteti është pronar i truallit 5/41 mbi të cilin është ndërtesa 5/41-nd ndalohej veprimi mbi këtë pasuri deri në rregullimin e marrëdhënieve ligjore me truallin dhe regjistrim i përqullit në sistemin hipotekar	
287	Tomor	Ahsh	Gjyla	2884	308/2	Truall+ndërtesë	500.00	457.7	3,560.00	1,629,412.00							196.5	196.50	52,000.00	10,218,000.00	11,847,412.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
288	Mujdin	Muharrem	Noka	2884	305/3	Truall+ndërtesë	162	90.1	3,560.00	320,756.00							190.1	190.1	52,000.00	9,885,200.00	10,205,956.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
289	Fatos	Muharrem	Noka	2884	305/18+1-1	Apartament											83.9	83.9	52,000.00	4,362,800.00	4,362,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
290	Muharrem	Rahim	Noka	2884	305/18+1-2	Apartament											83.9	83.9	52,000.00	4,362,800.00	4,362,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
291	Muharrem	Rahim	Noka	2884	305/18-B	Apartament											41.5	41.5	52,000.00	2,158,000.00	2,158,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
292	Ylli	Bayram	Metallari	2884	305/1	Truall+ndërtesë	500.3	482.4	3,560.00	1,717,344.00							305.4	305.4	52,000.00	15,880,800.00	17,598,144.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
293	Kapllan	Ashlan	Tola	2884	240/2	Truall+ndërtesë	496.60	496.6	3,560.00	1,767,896.00							169	169.00	52,000.00	8,788,000.00	10,555,896.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
294	Xhemali	Hysni	Allaraj	2884	240/16/ND	Ndërtesë											112.3	112.30	52,000.00	5,839,600.00	5,839,600.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Pasuria pozicionohet mbi pasurinë nr. 240/16, vol. 18, f. 88. në pronësi shtet vendoset hipotekë ligjore deri në pagesën e parcelës ndërtimore	
295	Teki	Xhevdet	Mandri	2884	240/11	Truall+ndërtesë	374.90	282.5	3,560.00	1,005,700.00							169.1	169.10	52,000.00	8,793,200.00	9,798,900.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
296	FIRMA	VEFA	HOLDING	2884	265/2	truall	2,065.00	1645	3,560.00	5,856,200.00			116.50	116.5	1522977							7,379,177.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
297	Skender	Egrem	Ahmari	2884	223/1	Truall+ndërtesë	300.00	196.1	3,560.00	698,116.00							117.2	117.20	52,000.00	6,094,400.00	6,792,516.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
298	Eduart	Mark	Gjinaj	2884	240/21	Truall+ndërtesë	151.80	151.8	3,560.00	540,408.00							50.6	50.60	52,000.00	2,631,200.00	3,171,608.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
299	Mustafa	Sulejman	Kabli	2884	31/3/ND2	Ndërtesë											80	80.00	52,000.00	4,160,000.00	4,160,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Objekti pozicionohet mbi pasurinë nr. 31/3, vol. 11 f. 41, në pronësi shtet sipërfaqja e parcelës për zhvillim 500 m <sup>2</sup> në pronësi shtet	
300	Zef	Ndoc	Bushqioka	8310	10/79-ND	Ndërtesë											46.46	46.46	96,753.41	4,495,163.43	4,495,163.43	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
301	Fejzo	Hekuran	Rapari	8310	10/49-ND	Ndërtesë											45	45.00	96,753.41	4,353,903.45	4,353,903.45	Konfirmuar nga ASHK-ja Ndërtesa me nr. pas-10/49-ND ndodhet mbi pasurinë nr. 10/49, sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 20/2020, ndërtimi është regjistruar pa marrëdhënie me truallin	
302	Zalo	Bayram	Topci	2460	606-ND11	Ndërtesë											147.7	147.7	66,505.00	9,822,788.50	9,822,788.50	Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 606 L. LEG. E. Vendoset hipotekë ligjore deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin	
VLERA TOTALE							7,707.30	5155.6	49,451,126.80	2,647.00	1,591.00	712,768.00	116.50	116.50	1522977	4,478.26	4,478.26		269,461,537.30	321,148,389.10			

**VENDIM****Nr. 749, datë 20.12.2023****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA  
REALIZIMI I PROJEKTIT  
“REHABILITIMI I PËRROIT, LUSHNJË,  
DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I  
ZONAVE RRETH TIJ”,  
BASHKIA LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i përroit, Lushnjë, dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, Bashkia Lushnjë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 5 834 380.9 (pesë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë pikë nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 834 380.9 (pesë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë pikë nëntë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletore Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, “REHABILITIMI I PËRROIT LUSHNJË DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I ZONAVE RRETH TIJ”, BASHKIA LUSHNJË

NR.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			SHËNIME (D+E) (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m <sup>2</sup> )	Ndërtesë (m <sup>2</sup> )	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )		Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)
1	FLAMUR SULEJMAN TAULLAI SUZANA VANGJEL TAULLAI			LUSHNJË	8572	19/36	TRUALL	260	260	112.5	28	41	22.4	8954	200569.6	200569.6	Konfirmuar nga ASHK-ja Në favor të Banka Credins. Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
2	AGRON RAMAZAN SHEFA			LUSHNJË	8572	19/6	TRUALL	200	200	50	18	131	45.6	8954	408302.4	408302.4	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
3	GENTIAN XIHEVIT TAULLAI			LUSHNJË	8572	19/37	TRUALL	200	200	108	28	94	1.4	8954	12535.6	12535.6	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
4	PERPARIM VAIT BASHLLARI MIRANDA AVDULLA BASHLLARI			LUSHNJË	8572	19/33	TRUALL	266.9	266.9	191.64	26	114	32	8954	286528	286528	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
5	MARKU PETRO DIMASHI			LUSHNJË	8572	5/3	TRUALL	380	380	105	12	10	47.5	8954	425315	425315	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
6	ALFRED JANI LALA ALMA DALIP LALA VLADIMIR JANI LALA ROZETA NDONI LALA MAKSIM JANI LALA ANILA THOMA LALA			LUSHNJË	8572	4/146	TRUALL	240	240	141			54	8954	483,516	483,516	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
7	ASPASIA PETRAQ DUSHI			LUSHNJË	8572	5/5	TRUALL	400	400	125			4	8954	35816	35816	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
8	FERDINANT MUSA BANI ALKETA MITI BANI			LUSHNJË	8572	5/4	TRUALL	260	260	115	13	222	37.8	8954	338461.2	338461.2	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.



9	LUSHE QEMAL SHURDHI	LUSHNJË	8572	20/194	TRUALL	300	300	107.6	27	22	40	8954	358160	358160	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
10	THEMI LEKSI PRIFTI	LUSHNJË	8572	4/6	TRUALL	465	465	93.3	29	111	38.9	8954	348310.6	348310.6	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
11	ANDON KOSTANDIN MËRTIKA	LUSHNJË	8572	19/14	TRUALL	200	200	105	29	111	13	8954	116402	116402	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
12	GËZIM FATMIR IDRIZI DRITAN FATMIR IDRIZI	LUSHNJË	8571	11/168	TRUALL	503	503		17	7	245	9709	2378705	2378705	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
13	GËZIM FATMIR IDRIZI DRITAN FATMIR IDRIZI	LUSHNJË	8571	11/169	TRUALL	437	437	0	17	8	45.5	9709	441759.5	441759.5	Konfirmuar nga ASHK-ja Sqarim. Nga shpronësimi preken pasuritë pronë private të llojit "truall", sipas shkresës së Bashkisë Lushnjë nr. 1105 prot., datë 8.2.2023, bashkëkëdhur kërkesës për shpronësim nr. 1355 prot., datë 15.2.2023.
<b>VLERA TOTALE</b>													<b>5834380.9</b>	<b>5834380.9</b>	



## VENDIM

Nr. 750, datë 20.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR. 778, DATË 24.9.2010,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, TOKË ARË, QË PREKEN NGA  
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR  
“BY-PASS PLEPA-KAVAJË-  
RROGOZHINË, LOTET 9, 10, 11 E 12”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 778, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, vlera “6 893 148 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë” zëvendësohet me “15 225 731 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e shpronësimit, prej 15 225 731 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 6 893 148 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë përballohen nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”;

b) 8 332 583 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë përballohen nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama





LISTA EMËRORE SHITESË E VENDIMIT NR. 778, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TOKË ARË, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY PASS, PLEPA–KAVAJË–RROGOZHINË, LOTET 9, 10, 11 E 12”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m <sup>2</sup> )	Sip. e shpronësimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera objekte	Vlera totale (lek)	Shënime	Adresa
	Emri	Atësia	Mbiemri										
1	Nazim	Murat	Saraçi	2140	242/5/2	Arë	22	22	329		7238	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
2	Bashkëpronarët		Saraçi	2140	242/6/2	Arë	71	71	329		23359	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
3	Astrit	Qamil	Sheshi	2140	242/7/1	Arë	4030	513	329		168777	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
4	Astrit	Qamil	Sheshi	2140	242/7/2	Arë	438	438	329		144102	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
5	Ilmi	Myftar	Saraçi	2140	242/8/1	Arë	848	147	329		48363	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
6	Ilmi	Myftar	Saraçi	2140	242/8/2	Arë	176	163	329		53627	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
7	Nexhmije	Hajdar	Mustafaj	2140	242/11/1	Arë	162	125	329		41125	Konfirmim	Bashkia Kavajë
8	Nexhmije	Hajdar	Mustafaj	2140	242/11/2	Arë	185	158	329		51982	Konfirmim	Bashkia Kavajë
9	Gezim	Adem	Hidri	2140	242/20/1	Arë	272	272	329		89488	Lëshuar Certifikatë e pronësisë sipas aktit me sip. 272 m <sup>2</sup>	Komuna Kërçukaj
	Irma	Adem	Hamataj										
	Kadrije	Mustafa	Hidri										
	Vitjola	Adem	Hidri										
10	Gezim	Adem	Hidri	2140	242/20/2	Arë	1270	1109	329		364861	Ish-serrat, autostrada Dr-Rrog., segment i devijuar sip. sipas aktit 1270 m <sup>2</sup>	Komuna Kërçukaj
	Irma	Adem	Hamataj										
	Kadrije	Mustafa	Hidri										
	Vitjola	Adem	Hidri										
11	Xhavid	Jahja	Islami	2140	242/17	Arë	1003	253	329		83237	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
12	Tahir	Ali	Shamo	2140	242/19/7	Arë	607	274	329		90146	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
13	Tahir	Ali	Shamo	2140	242/19/6	Arë	390	344	329		113176	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
14	Xhevat	Hajdar	Saraçi	2140	242/21/5	Arë	5237	815	329		268135	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
15	Alan	Algert	Saraçi	2140	242/22/1	Arë	5238	799	329		262871	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
	Algert	Flamur											
	Englantina	Haxhi											
	Flamur	Hajdar											
	Lorenc	Flamur											
	Xhevrije	Flamur											
16	Bashkëpronarët Saraçi			2140	242/22/6	Arë	1260	1107	329		364203	Konfirmim	Komuna Gose
17	Qerim	Harun	Sheshi	2140	242/24/6	Arë	690	607	329		199703	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
18	Bajram	Halim	Krasnaj	2140	40/1/1	Arë	8544	391	329		128639	Ndalohen veprimet mbi pasuritë. Urdhër kufizimi	Komuna Kërçukaj
19	Bajram	Halim	Krasnaj	2140	40/1/2	Arë	1747	1725	329		567525	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
20	Bajram	Halim	Krasnaj	2140	40/1/3	Arë	578	16	329		5264	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
21	Rifat	Halim	Krasniqi	2140	40/2/1	Arë	6576	209	329		68761	Konfirmim	Komuna Gose
22	Skënder	Riza	Thartori	2140	33/1/1	Arë	377	10	329		3290	Mbi pasurinë e rivl. u krye transaksion	Bashkia Kavajë
	Mirjana												
23	Besnik	Kadri	Shehu	2140	33/1/2	Arë	75	75	329		24675	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
24	Bashkëpronarët Thartori			2140	33/1/3	Arë	52	6	329		1974	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
25	Bashkëpronarët Shkëmbi, Shkëmbi			2140	33/2/1	Arë	4564	150	329		49350	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
26	Ruka	Jakup	Saraci	2140	33/2/2	Arë	955	955	329		314195	Konfirmim	Komuna Gose
27	Ruka	Jakup	Saraci	2140	33/2/3	Arë	583	48	329		15792	Konfirmim	Komuna Gose
28	Lirije	Riza	Saraçi	2140	33/3/2	Arë	990	990	329		325710	Konfirmim	Komuna Gose
29	Lirije	Riza	Saraçi	2140	33/3/3	Arë	399	24	329		7896	Konfirmim	Komuna Gose



30	Adriatik	Shyqyri	Koçi	2140	33/4/2	Arë	936	936	329		307944	Konfirmim	Komuna Gose
31	Adriatik	Shyqyri	Koçi	2140	33/4/3	Arë	276	48	329		15792	Konfirmim	Komuna Gose
32	Mustafa	Izet	Shehu	2140	33/5/1	Arë	10692	119	329		39151	Konfirmim	Bashkia Kavajë
33	Mustafa	Izet	Shehu	2140	33/5/2	Arë	1962	1951	329		641879	Konfirmim	Bashkia Kavajë
34	Mustafa	Izet	Shehu	2140	33/5/3	Arë	272	195	329		64155	Konfirmim	Bashkia Kavajë
35	Astrit	Asllan	Shehi	2140	33/6/2	Arë	986	978	329		321762	Konfirmim	Bashkia Kavajë, Rruga Zikxhafaj, nr. 64
36	Nebi	Selman	Saraçi	2140	34/3	Arë	7784	26	329		8554	Konfirmim	Komuna Gose
37	Zana	Myrteza	Saraçi	2140	34/5/2	Arë	5470	127	329		41783	Konfirmim	Bashkia Kavajë
38	Galip	Myftar	Saraçi	2140	34/6/1	Arë	530	530	329		174370	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
39	Galip	Myftar	Saraçi	2140	34/6/2	Arë	7921	7921	329		2606009	Konfirmim	Komuna Kërçukaj
40	Myftar	Sefer	Tafa	2399	125/40	Arë	1643	276	329		90804	Konfirmim	Bashkia Lekaj
41	Reshit	Dylaver	Dedej	2399	77/8	Arë	871	100	329		32900	Konfirmim	Bashkia Lekaj
42	Bedri	Qazim	Mema	2399	77/6	Arë	3780	304	329		100016	Konfirmim	Bashkia Lekaj
<b>SHUMA TOTALE</b>							84168	24647			<b>8332583</b>		

**VENDIM****Nr. 751, datë 20.12.2023****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË  
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT  
TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Z. Lefter Shehaj, prefekt i Qarkut të Fierit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Rajmonda Balilaj emërohet prefekt i Qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 752, datë 20.12.2023****PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË  
FONDEVE DHE QËNDRIMIT NË NJË  
TERRITOR TË CAKTUAR TË  
SHTETASVE TË HUAJ, TË  
URDHËRUAR PËR TË QËNDRUAR NË  
NJË TERRITOR TË CAKTUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 113, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fondet për qëndrimin në një territor të caktuar të një shtetasi të huaj, i cili është urdhëruar të qëndrojë në një territor të caktuar, përdoren në përputhje me programin buxhetor dhe zërat e shpenzimeve të parashikuara për çdo vit.

2. Zërat e shpenzimeve për sigurimin e kushteve për qëndrimin e shtetasve të huaj në një territor të caktuar përfshijnë:

a) sigurimin e strehimit, të ushqimit e të veshmbathjes;

b) ndihmën financiare me një kuotë mujore prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj.

3. Administrimi i fondeve kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH).

4. Administrimi i fondit për zërin sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Për dhënien e ndihmës financiare sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, DPPSH-ja kërkon hapjen e llogarisë ekonomike analitike të shpenzimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ), me emërtimin “Shpenzime për ndihmën financiare për shtetasin e huaj të urdhëruar për të qëndruar në një territor të caktuar”.

6. Transferimet e mjeteve monetare nga fondet e përcaktuara për qëndrimin e shtetasit të huaj në një territor të caktuar të përfituesit kryhen nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në përputhje me skemën ekzistuese të ekzekutimit të pagesave të përfituesit individë nëpërmjet strukturës së thesarit.

7. DPPSH-ja raporton, brenda datës 5 të muajit pasardhës, për të gjitha pagesat e kryera gjatë muajit paraardhës, si dhe brenda datës 31 janar të vitit pasardhës për të gjitha pagesat e kryera gjatë vitit paraardhës.

8. Shtetasi i huaj, i cili është urdhëruar të qëndrojë në një territor të caktuar, qëndron në një ambient ose rezidencë akomoduese. Ambienti ose rezidenca akomoduese e destinuar për një shtetas të huaj është një apartament, shtëpi private, strehëz, qendër e hapur apo hotel.

9. Kur shtetasi i huaj, i cili është urdhëruar të qëndrojë në një territor të caktuar hyn në marrëdhënie pune, trajtimi financiar për strehimin, ushqimin, veshmbathjet dhe ndihma financiare ndërpriten.

10. Shtetasi i huaj, i cili është urdhëruar të qëndrojë në një territor të caktuar është i detyruar të respektojë rregullat e regjimit ditor në varësi të llojit dhe rregullave të ambientit ose rezidencës akomoduese.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**



## VENDIM

Nr. 753, datë 20.12.2023

**PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË  
LIGJIT NR. 29/2023, “PËR TATIMIN MBI  
TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, pika 3, 17, pika 6, 49 dhe 69, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

## Neni 1

**Lista e veprimtarive për zbatimin e regjimit të veçantë për personat fizikë tregtarë dhe të vetëpunësuar**

1. Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 29/2023, të ndryshuar, ndarja e veprimtarive të parashikuara në këtë nen bëhet duke u bazuar në kodet e përcaktuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (rev. 2), të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të publikuar nga INSTAT-i.

2. Bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (rev. 2), ndarja e llojeve të veprimtarive ekonomike përkatësisht sipas veprimtarive të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit, pasqyrohet në tabelën analitike nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

## Neni 2

**Vlerësimi i kostos dhe i çmimit të shitjes së sipërfaqeve të ndërtimit të përfutuara si rezultat i një kontrate shkëmbimi truall me ndërtesë**

1. Në zbatim të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr. 29/2023, të ndryshuar, parashikohet dispozita ligjore në lidhje me tatimin e fitimit kapital të realizuar nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përfutuar nga një kontratë shkëmbimi. Në momentin e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk lind detyrim për llogaritje të fitimit kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme si për shoqëritë e ndërtimit, ashtu edhe për pronarët e truallit, pavarësisht nga statusi. Në këtë rast, fitimi kapital lind në momentin

e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme të fituar nga shkëmbimi.

2. Me termin “fitim kapital i realizuar” kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme. Në rastet kur kjo diferencë rezulton negative, atëherë fitimi kapital do të konsiderohet zero në çdo transaksion.

3. Në rastin e shitjes së një pasurie të paluajtshme të përfutuar nga një kontratë shkëmbimi truall-ndërtesë, për të llogaritur fitimin kapital të realizuar, vlera në blerje dhe vlera në shitje përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Vlera në blerje do të konsiderohet vlera e pjesës së truallit që i takon sipërfaqes së ndërtesës që shitet:

i. Vlera e truallit, për metër katror ( $m^2$ ) të dhënë në këmbim të përfitimit të sipërfaqes së banimit/tregtisë/shërbimit përcaktohet bazuar në vlerën, që ka pasur truallin i dhënë në transaksionin e fundit përpara shkëmbimit. Kur pronari i truallit e ka përfutuar këtë truall me një transaksion, sikurse janë kontratë blerjeje, shkëmbimi, trashëgimi, dhurimi, heqje dorë apo rivlerësim i pasurisë së paluajtshme, për të cilin është llogaritur tatimi dhe ky akt është regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, vlera në blerje do të jetë vlera sipas regjistrimit të fundit të kësaj pasurie mbi të cilën është llogaritur tatimi. Kjo vlerë, në rast se ekziston një akt tjetërsimi pasurie, u mundësohet noterëve gjatë kërkesës për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga organi kompetent për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme;

ii. Në rastet kur për truallin e këmbyer nuk ekziston një vlerë sipas parashikimeve të nënndarjes “I”, të kësaj shkronje, si vlerë e truallit për metër katror ( $m^2$ ) të dhënë në këmbim të përfitimit të sipërfaqes së banimit ose tregtisë, ose shërbimit do të konsiderohet vlera, sipas çmimeve për metër katror ( $m^2$ ) sipërfaqe truall të dhënë, që parashikohen në hartën e vlerave të tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi në momentin e regjistrimit të kontratës së shkëmbimit ndërmjet investitorit e pronarit të truallit në organin përgjegjës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme;

b) Vlera në shitje e ndërtesës përcaktohet në kontratën e shitjes, e cila është nënshkruar nga palët, shitësi dhe blerësi:

i. Kontrata parashikon sipërfaqen në metër katror ( $m^2$ ) të pasurisë objekt të kontratës, çmimin



për metër katror ( $m^2$ ) dhe vlerën e saj. Kontrata shoqërohet me hartën, planimetrinë dhe dokumentet e tjera, që shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit të fushës. Kjo vlerë në shitje e përcaktuar në kontratën e shitjes, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, krahasohet me çmimet e referencës;

ii. Në rastet kur vlera e pasurisë sipas çmimit të shitjes për metër katror ( $m^2$ ) të përcaktuar në kontratë është më e ulët se vlera sipas çmimeve referuese, atëherë si çmim i supozuar shitjeje merret në konsideratë çmimi i referencës së zonës/qytetit. Çmimet e referencës janë çmimet mesatare referuese për metër katror ( $m^2$ ) sipërfaqe ndërtimi që përdoren për vlerësimin e vlerës së taksueshme për banesat, bazuar në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe institucionit që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të nxjerrë në zbatim të pikës 8, të nenit 17, të ligjit nr. 29/2023, të ndryshuar.

### Neni 3

#### **Shpenzimet dhe të ardhurat në sektorin e ndërtimit**

1. Dispozitat e këtij neni zbatohen për përcaktimin e fitimit të tatuashëm të sipërmarrjeve, që operojnë në ndërtimin dhe/ose shitjen e ndërtesave për qëllim strehimi, veprimtari prodhuese, tregtare ose veprimtari të shërbimit, sipas parashikimit në nenin 49, të ligjit nr. 29/2023, të ndryshuar.

2. Tatimpaguesit që operojnë si sipërmarrës të punimeve të ndërtimit, për llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Në rastet kur tatimpaguesit operojnë si sipërmarrës në punime ndërtimi në rolin e kontraktorit, nënkontraktorit, supervizorit, mbikëqyrësit etj., të ardhurat nga biznesi janë të ardhurat e faturuara, bazuar në situacionet e punimeve të kryera apo paradhëniet e marra nga porositesit e punimeve;

b) Shpenzimet e tatimpaguesve, që operojnë si sipërmarrës në punime ndërtimi në rolin e kontraktorit, nënkontraktorit, supervizorit, mbikëqyrësit etj. përbëhen nga shpenzimet e biznesit brenda kufizimeve të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

3. Tatimpaguesit, që operojnë si ndërtues dhe shitës të punimeve të ndërtimit, për llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Në rastet kur tatimpaguesit operojnë si ndërtues të objekteve të ndërtimit dhe njëkohësisht janë pronarë plotësisht apo pjesërisht të produktit të ndërtimit, të cilin e shesin apo e japin me qira, të ardhurat nga biznesi janë të ardhurat nga pjesa, që shitet e produktit të ndërtimit, si dhe të ardhurat nga qiraja për pjesën e produktit të ndërtimit që jepet me qira:

i. Në rastet kur tatimpaguesi është 100% pronar i truallit ku ndërtohet, të ardhurat nga shitja apo dhënia me qira e produktit të ndërtimit do të llogariten për 100 % të produktit të ndërtimit;

ii. Në rastet kur tatimpaguesi nuk është pronar 100% i truallit ku ndërtohet, por ka një kontratë shkëmbimi truall–ndërtesë me pronarët e truallit, të ardhurat nga shitja apo dhënia me qira e produktit të ndërtimit llogariten për pjesën përfituese të produktit të ndërtimit bazuar në kontratën e shkëmbimit ndërmjet palëve;

b) Të ardhurat nga shitja e produkteve të ndërtimit, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e tyre llogariten bazuar në kontratat e shitjes, por duke marrë në konsideratë çmimet minimale të shitjes apo tarifatat minimale të qiradhënies të përcaktuara në aktet ligjore e nënljore në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

c) Shpenzimet e tatimpaguesve, që operojnë si ndërtues të objekteve të ndërtimit dhe njëkohësisht janë pronarë plotësisht apo pjesërisht të produktit të ndërtimit, përbëhen nga shpenzimet e zbritshme të biznesit për fazën e ndërtimit, fazën e shitjes apo të mirëmbajtjes për pjesën e objekteve që jepen me qira, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat;

ç) Në rastet kur shoqëritë e ndërtimit disponojnë në aktivet e shoqërisë troje të blera dhe, bazuar në lejet e ndërtimit, përdorin pjesë të tyre për ndërtimin e godinave me qëllim rishitjeje, për pjesën e truallit, i cili i përket pjesës së shitur të godinës, truall që çregjistrohet si pronë e entitetit në ASHK dhe kalon në pronësi/bashkëpronësi të blerësve të produktit të ndërtimit, vlera në kontabilitet e tij kalohet si shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë së ndërtimit me qëllim shitjeje. Nëse entiteti mban produkte ndërtimi për nevoja të veprimtarisë së tij, si: zyra, magazina, dhënie me qira, bare, restorante etj., pjesa



përkatëse e truallit, që u përket proporcionalisht këtyre aktiveve, nuk do kalojë si shpenzim i zbritshëm biznesi.

3. Tatimpaguesit, që operojnë si investitorë dhe shitës të produkteve të ndërtimit, për llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve veprojnë, si më poshtë vijon:

Në rastet kur tatimpaguesit operojnë si investitorë, financues të produktit të ndërtimit, të ardhurat nga biznesi janë të ardhurat nga shitja e produktit të ndërtimit, si dhe të ardhurat nga qiraja për pjesën e produktit të ndërtimit që mbahet nga ana e tyre për t'u dhënë me qira.

a) Të ardhurat nga shitja e produkteve të ndërtimit, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e tyre llogariten bazuar në kontratat ligjore të shitjes, por duke marrë në konsideratë çmimet minimale të shitjes apo tarifatat minimale të qiradhënies të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

b) Shpenzimet e tatimpaguesve, që operojnë si investitorë (financues) të produktit të ndërtimit dhe njëkohësisht janë pronarë të këtij produkti, përbëhen nga shpenzimet e faturuara për ta nga sipërmarrësit e punimeve apo shpenzimet e tjera të nevojshme në fazën e shitjes apo të dhënies me qira, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 4

### Lista e shërbimeve objekt tatimi nga 1 janari 2024

1. Në zbatim të nenit 69, të ligjit nr. 29/2023, të ndryshuar, përcaktohet lista analitike e veprimtarive ekonomike të tatimpaguesve, persona fizikë të vetëpunësuar dhe entitete, që ofrojnë shërbime profesionale, me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët do të paguajnë tatim mbi të ardhurat personale nga biznesi apo tatim mbi të ardhurat e korporatës, duke filluar nga viti fiskal 2024. Lista analitike përbëhet nga veprimtaritë sipas kodeve të parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (rev. 2), të paraqitura në tabelën analitike nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në rastet kur tatimpaguesit nuk janë të qartë në lidhje me kategorizimin e veprimtarisë ekonomike që ushtrojnë apo për normën e tatimit mbi të ardhurat në lidhje me veprimtarinë e tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (rev. 2), përcakton ndarjen dhe aktivitetin, në të cilin bën pjesë tatimpaguesi përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

Tabela analitike nr. 1

Lloji i veprimtarisë	Ndarja NVE Rev 2	Kodi NVE Rev 2	Përshkrimi
Veprimtaritë prodhuese	Ndarja 01	A111, A112, A113, A114, A115, A116, A119, A121, A122, A123, A124, A125, A126, A127, A128, A129, A130, A141, A142, A143, A144, A145, A146, A147, A149, A150, A161, A162, A163, A164, A170	Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbime të lidhura me to
	Ndarja 02	A210, A220, A230, A240	Pyjet dhe shfrytëzimi i pyjeve
	Ndarja 03	A311, A312, A321, A322	Peshkimi dhe Akuakultura
	Ndarja 05	B510, B520	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve
	Ndarja 06	B610, B620	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror
	Ndarja 07	B710, B721, B729	Nxjerrja e mineraleve metalore
	Ndarja 08	B811, B812, B891, B892, B893, B899	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat
	Ndarja 09	B910, B990	Aktivitete mbështetëse minerare
	Ndarja 10	C1011, C1012, C1013, C1020, C1031, C1032, C1039, C1041, C1042, C1051,	Përpunimi i produkteve ushqimore



	C1052, C1061, C1062, C1071, C1072, C1073, C1081, C1082, C1083, C1084, C1085, C1086, C1089, C1091, C1092	
Ndarja 11	C1101, C1102, C1103, C1104, C1105, C1106, C1107	Prodhimi i pijeve
Ndarja 12	C1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
Ndarja 13	C1310, C1320, C1330, C1391, C1392, C1393, C1394, C1395, C1396, C1399	Përpunimi i tekstileve
Ndarja 14	C1411, C1412, C1413, C1414, C1419, C1420, C1431, C1439	Konfeksionimi i veshjeve
Ndarja 15	C1511, C1512, C1520	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure
Ndarja 16	C1610, C1621, C1622, C1623, C1624, C1629	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve
Ndarja 17	C1711, C1712, C1721, C1722, C1723, C1724, C1729	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre
Ndarja 18	C1811, C1812, C1813, C1814, C1820	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara
Ndarja 19	C1910, C1920	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës
Ndarja 20	C2011, C2012, C2013, C2014, C2015, C2016, C2017, C2020, C2030, C2041, C2042, C2051, C2052, C2053, C2059, C2060	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike
Ndarja 21	C2110, C2120	Përpunimi i produkteve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike
Ndarja 22	C2211, C2219, C2221, C2222, C2223, C2229	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës
Ndarja 23	C2311, C2312, C2313, C2314, C2319, C2320, C2331, C2332, C2341, C2342, C2343, C2344, C2349, C2351, C2352, C2361, C2362, C2363, C2364, C2365, C2369, C2370, C2391, C2399	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike
Ndarja 24	C2410, C2420, C2431, C2432, C2433, C2434, C2441, C2442, C2443, C2444, C2445, C2446, C2451, C2452, C2453, C2454	Metalurgjia
Ndarja 25	C2511, C2512, C2521, C2529, C2530, C2540, C2550, C2561, C2562, C2571, C2572, C2573, C2591, C2592, C2593, C2594, C2599	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve
Ndarja 26	C2611, C2612, C2620, C2630, C2640, C2651, C2652, C2660, C2670, C2680	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë
Ndarja 27	C2711, C2712, C2720, C2731, C2732, C2733, C2740, C2751, C2752, C2790	Prodhimi i pajisjeve elektrike
Ndarja 28	C2811, C2812, C2813, C2814, C2815, C2821, C2822, C2823, C2824, C2825, C2829, C2830, C2841, C2849, C2891, C2892, C2893, C2894, C2895, C2896, C2899	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t
Ndarja 29	C2910, C2920, C2931, C2932	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove
Ndarja 30	C3011, C3012, C3020, C3030, C3040, C3091, C3092, C3099	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit
Ndarja 31	C3101, C3102, C3103, C3109	Prodhimi i mobileve
Ndarja 32	C3211, C3212, C3213, C3220, C3230, C3240, C3250, C3291, C3299	Industri të tjera p.k.t



	Ndarja 35	D3511, D3512, D3513, D3514, D3521, D3522, D3523, D3530	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar
	Ndarja 36	E3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë
	Ndarja 37	E3700	Ujërat e zeza
	Ndarja 38	E3811, E3812, E3821, E3822, E3831, E3832	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve
	Ndarja 39	E3900	Shërbime të tjera të pastrimit e të menaxhimit të mbetjeve
	Ndarja 41	F4110, F4120	Ndërtimi i ndërtesave
	Ndarja 42	F4211, F4212, F4213, F4221, F4222, F4291, F4299	Punime inxhinierike
	Ndarja 43	F4311, F4312, F4313, F4321, F4322, F4329, F4331, F4332, F4333, F4334, F4339, F4391, F4399	Punime të specializuara ndërtimi
	Ndarja 98	T9810, T9820	Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorim të vet
Veprimtaritë e tregtimit me shumicë	Ndarja 46	G4611, G4612, G4613, G4614, G4615, G4616, G4617, G4618, G4619, G4621, G4622, G4623, G4624, G4631, G4632, GG4633, G4634, G4635, G4636, G4637, G4638, G4639, G4641, G4642, G4643, G4644, G4645, G4646, G4647, G4648, G4649, G4651, G4652, G4661, G4662, G4663, G4664, G4665, G4666, G4669, G4671, G4672, G4673, G4674, G4675, G4676, G4677, G4690	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave
Veprimtaritë e tregtimit me pakicë të mallrave dhe transportit individual	Ndarja 45	G4511, G4519, G4520, G4531, G4532, G4540	Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
	Ndarja 47	G4711, G4719, G4721, G4722, G4723, G4724, G4725, G4726, G4729, G4730, G4741, G4742, G4743, G4751, G4752, G4753, G4754, G4759, G4760, G4761, G4762, G4763, G4764, G4765, G4771, G4772, G4773, G4774, G4775, G4776, G4777, G4778, G4779, G4781, G4782, G4789, G4791, G4799	Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave
	Ndarja 49	H4910, H4920, H4931, H4932, H4939, H4941, H4942, H4950	Transporti tokësor dhe me tubacione
	Ndarja 50	H5010, H5020, H5030, H5040	Transporti ujor
	Ndarja 51	H5110, H5121, H5122	Transporti ajror
Veprimtaritë bare, restorante, disko, etj., të kësaj natyre	Ndarja 56	I5610, I5621, I5629, I5630	Shërbime ushqimi dhe pije
Veprimtaritë e shërbimeve, veprimtaritë artizanale dhe zejtare	Ndarja 52	H5210, H5221, H5222, H5223, H5224, H5229	Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin
	Ndarja 53	H5310, H5320	Aktivitete të postës dhe korrierës
	Ndarja 55	I5510, I5520, I5530, I5590	Akomodimi
	Ndarja 60	J6010, J6020	Aktivitete të programimit dhe shpërndarjes
	Ndarja 61	J6110, J6120, J6130, J6190	Telekomunikacioni
	Ndarja 85	P8510, P8520, P8531, P8532, P8541, P8542, P8551, P8552, P8553, P8559, P8560	Arsimi





	Ndarja 91	R9101, R9102, R9103, R9104	Bibliotekat, arkivat, muzeumet dhe të tjera aktivitete kulturore
	Ndarja 92	R9200	Aktivitete të lojërave të fatit dhe basteve
	Ndarja 93	R9311, R9312, R9313, R9319, R9321, R9329	Aktivitete sportive, argëtuese dhe çlodhëse
Individët vetëpunësuar	Ndarja 33	C3311, C3312, C3313, C3314, C3315, C3316, C3317, C3319, C3320	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
	Ndarja 58	J5811, J5812, J5813, J5814, J5819, J5821, J5829	Aktivitete publikimi
	Ndarja 59	J5911, J5912, J5913, J5914, J5920	Filma, video dhe prodhimi i programeve televizivë, regjistrimi i zërit dhe aktivitete publikimi të muzikës
	Ndarja 62	J6201, J6202, J6203, J6209	Shërbime të teknologjisë së informacionit
	Ndarja 63	J6311, J6312, J6391, J6399	Aktivitete të shërbimit të informacionit
	Ndarja 64	K6411, K6419, K6420, K6430, K6491, K6492, K6499	Aktivitete të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe financimit të pensioneve
	Ndarja 65	K6511, K6512, K6520, K6530	Sigurimi, risigurimi dhe financimi i fondeve të pensioneve, përjashtuar sigurimin shoqëror të detyrueshëm
	Ndarja 66	K6611, K6612, K6619, K6621, K6622, K6629, K6630	Aktivitete të tjera financiare
	Ndarja 68	L6810, L6820, L6831, L6832	Aktivitete të pasurive të paluajtshme
	Ndarja 69	M6910, M6920	Aktivitete juridike dhe të kontabilitetit
	Ndarja 70	M7010, M7021, M7022	Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit
	Ndarja 71	M7111, M7112, M7120	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike
	Ndarja 72	M7211, M7219, M7220	Kërkim dhe zhvillim shkencor
	Ndarja 73	M7311, M7312, M7320	Publiciteti dhe kërkimet e tregut
	Ndarja 74	M7410, M7420, M7430, M7490	Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike
	Ndarja 75	M7500	Aktivitete Veterinare
	Ndarja 77	N7711, N7712, N7721, N7722, N7729, N7731, N7732, N7733, N7734, N7735, N7739, N7740	Aktivitete të marrjes e dhënies me qira
	Ndarja 78	N7810, N7820, N7830	Aktivitete të punësimit
	Ndarja 79	N7911, N7912, N7990	Agjenci udhëtimi, operator turistik dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit
	Ndarja 80	N8010, N8020, N8030	Aktivitete të sigurimit dhe hetimit
	Ndarja 81	N8110, N8121, N8122, N8129, N8130	Shërbime ndaj ndërtesave dhe shesheve
	Ndarja 82	N8211, N8219, N8220, N8230, N8291, N8292, N8299	Administrim zyrash, mbështetje administrative dhe të tjera aktivitete mbështetëse të ndërmarrjeve
	Ndarja 84	O8411, O8412, O8413, O8421, O8422, O8423, O8424, O8425, O8430	Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm
	Ndarja 86	Q8610, Q8621, Q8622, Q8623, Q8690	Aktivitete të shëndetit
	Ndarja 87	Q8710, Q8720, Q8730, Q8790,	Aktivitete të qendrave të kujdesit mjekësor e social
	Ndarja 88	Q8810, Q8891, Q8899	Aktivitete të kujdesit social pa akomodim
Ndarja 90	R9001, R9002, R9003, R9004	Aktivitete krijuese, arte, dhe aktivitete çlodhëse	
Ndarja 94	S9411, S9412, S9420, S9491, S9492, S9499	Aktivitetet e shoqatave e organizatave	



Ndarja 95	S9511, S9512, S9521, S9522, S9523, S9524, S9525, S9529	Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personale dhe familjarë
Ndarja 96	S9601, S9602, S9603, S9604, S9609	Aktivitete të tjera shërbimi
Ndarja 97	T9700	Aktivitete të familjeve si punëdhënës të personelit shtëpiak
Ndarja 99	U9900	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

Tabela analitike nr. 2

Ndarja	Grupi/ klasa	Kodi NVE Rev 2	Lloji i aktivitetit
Ndarja 59			Filma, video dhe prodhimi i programeve televizivë, regjistrimi i zërit dhe aktivitete të prodhimit të muzikës
	59.2		Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës
	59.20	J5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës
Ndarja 62			Shërbime të teknologjisë së informacionit
	62.0		Programacioni, këshillime dhe aktivitete të tjera informatike
	62.01	J6201	Aktivitete të programimit informatik
	62.02	J6202	Aktivitete të këshillimeve informatike
	62.03	J6203	Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike
	62.09	J6209	Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit
Ndarja 63			Aktivitete të shërbimit të informacionit
	63.1		Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse ( <i>hosting</i> ) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to, portat <i>web</i>
	63.11	J6311	Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse ( <i>hosting</i> ) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to
	63.12	J6312	Portat <i>web</i>
	63.9		Shërbime të tjera të informacionit
	63.91	J6391	Aktivitete të agjencive të lajmeve
	63.99	J6399	Shërbime të tjera informacioni p.k.t
Ndarja 64			Aktivitete të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe financimit të pensioneve
	64.1		Ndërmjetësim Monetar
	64.19	K6419	Ndërmjetësime të tjera financiare
	64.9		Ndërmjetësime të tjera financiare
	64.91	K6491	<i>Leasing</i> (Qiramarrja financiare)
	64.92	K6492	Aktivitete të tjera garantimit të kredisë
	64.99	K6499	Ndërmjetësime të tjera financiare, përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit, p.k.t.
Ndarja 65			Sigurimi, risigurimi dhe financimi i fondeve të pensioneve, përjashtuar sigurimin shoqëror të detyrueshëm
	65.1		Sigurimi
	65.11	K6511	Sigurimi i jetës
	65.12	K6512	Sigurime jo jetësore



	65.2		Risigurimi
	65.20	K6520	Risigurimi
	65.3		Financimi i Pensioneve
	65.30	K6530	Financimi i Pensioneve
Ndarja 66			Aktivitete të tjera financiare
	66.1		Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar përveç sigurimit dhe financimit të pensioneve
	66.11	K6611	Administrimi i tregjeve financiare
	66.12	K6612	Aktivitete të sigurimit dhe kontratave të të mirave
	66.19	K6619	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, përveç sigurimit dhe financimit të pensioneve p.k.t
	66.2		Aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve
	66.21	K6621	Vlerësimi i riskut dhe dëmit
	66.22	K6622	Aktivitete të agjentëve të sigurimit dhe komisionerëve
	66.29	K6629	Të tjera aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve
	66.3		Menaxhimi i fondeve
	66.30	K6630	Menaxhimi i fondeve
Ndarja 68			Aktivitete të pasurive të paluajtshme
	68.1		Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme
	68.10	L6810	Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet
	68.2		Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira
	68.20	L6820	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira
	68.3		Aktivitete të pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë
	68.31	L6831	Agjencitë e pasurive të paluajtshme
	68.32	L6832	Menaxhimi i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë
Ndarja 69			Aktivitete juridike dhe të kontabilitetit
	69.1		Aktivitete juridike
	69.10	M6910	Aktivitete juridike
	69.2		Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat
	69.20	M6920	Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat
Ndarja 70			Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit
	70.1		Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve
	70.10	M7010	Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve
	70.2		Aktivitete të konsulencës menaxheriale
	70.21	M7021	Aktivitete të marrëdhënieve publike dhe të komunikimit
	70.22	M7022	Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin
Ndarja 71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike



	71.1		Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to
	71.11	M7111	Aktivitete arkitekturore
	71.12	M7112	Aktivitete inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to
	71.2		Testimet dhe analizat teknike
	71.20	M7120	Testimet dhe analizat teknike
Ndarja 73			Publiciteti dhe kërkimet e tregut
	73.1		Publicitet
	73.11	M7311	Agjenci publiciteti
	73.12	M7312	Shërbime të përfaqësimit të mediave
	73.2		Studimi i tregut dhe sondazhet
	73.20	M7320	Studimi i tregut dhe sondazhet
Ndarja 74			Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike
	74.1		Aktivitete të specializuara skicimi
	74.10	M7410	Aktivitete të specializuara skicimi
	74.2		Aktivitete fotografike
	74.20	M7420	Aktivitete fotografike
	74.3		Aktivitete përkthimi dhe interpretimi
	74.30	M7430	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi
	74.9		Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t
	74.90	M7490	Të tjera aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t
Ndarja 75			Aktivitete veterinare
	75.0		Aktivitete veterinare
	75.00	M7500	Aktivitete veterinare
Ndarja 77			Aktivitete të marrjes e dhënies me qira
	77.1		Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit
	77.11	N7711	Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit
	77.12	N7712	Dhënia me qira dhe hua e kamionëve
	77.2		Dhënia me qira dhe hua e orendive personale dhe shtëpiake
	77.21	N7721	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të kohës së lirë dhe mallra sportive
	77.22	N7722	Dhënia me qira e video-kasetave dhe disqeve
	77.29	N7729	Dhënia me qira dhe hua e sendeve personale dhe e orendive shtëpiake të papërfshira
	77.3		Dhënia me qira dhe hua e makinerive, pajisjeve dhe mallra të tjera të trupëzuara
	77.31	N7731	Dhënia me qira dhe hua e makinerive bujqësore dhe pajisjeve
	77.32	N7732	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinierike
	77.33	N7733	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterët)
	77.34	N7734	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të transportit të ujit
	77.35	N7735	Dhënia me qira dhe hua të pajisjeve të transportit ajror



	77.39	N7739	Dhënie me qira dhe hua të makinerive dhe pajisjeve të tjera dhe mallrave të prekshëm të papërfshira
	77.4		Dhënie me qira e të mirave jo-financiare të patrupëzuara
	77.40	N7740	Dhënie me qira e të mirave jo-financiare të patrupëzuara
Ndarja 78			Aktivitete të punësimit
	78.0		Aktivitete të agjencive të punësimit
	78.10	N7810	Aktivitete të agjencive të punësimit
	78.2		Agjenci të punësimit të përkohshëm
	78.20	N7820	Agjenci të punësimit të përkohshëm
	78.3		Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore
	78.30	N7830	Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore
Ndarja 79			Agjenci udhëtimi, operator turistik dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit
	79.1		Agjenci udhëtimi dhe aktivitete të operatorëve turistikë
	79.11	N7911	Aktivitete të agjencive të udhëtimit
	79.12	N7912	Aktivitete të operatorëve turistikë
	79.9		Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim
	79.90	N7990	Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim
Ndarja 80			Aktivitete të sigurimit dhe hetimit
	80.1		80.1 Aktivitete private sigurimi
	80.10	N8010	80.10 Aktivitete private sigurimi
	80.2		80.2 Aktivitete të shërbimeve të sigurimit
	80.20	N8020	80.20 Aktivitete të shërbimeve të sigurimit
	80.3		80.3 Aktivitete hetimi
	80.30	N8030	80.30 Aktivitete hetimi
Ndarja 82			Administrim zyrash, mbështetje administrative dhe të tjera aktivitete mbështetëse
	82.1		Administrim zyrash dhe aktivitete mbështetëse
	82.11	N8211	Aktivitete të kombinuara të shërbimit të administrimit të zyrave
	82.2		Aktivitete të qendrave telefonike ( <i>call center</i> )
	82.20	N8220	Aktivitete të qendrave telefonike ( <i>call center</i> )
	82.3		Organizatorë të konferencave dhe panairëve
	82.30	N8230	Organizatorë të konferencave dhe panairëve
	82.9		Aktivitete shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t.
	82.91	N8291	Aktivitete të agjencive të mbledhjes së dokumentacionit dhe zyra krediti
	82.99	N8299	Aktivitete të tjera shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t.
Ndarja 84			Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm
	84.2		Kryerja e shërbimeve ndaj komunitetit
	84.23	O8423	Drejtesi dhe aktivitete juridike
Ndarja 85			Arsimi
	85.1		Arsimi parashkollor
	85.10	P8510	Arsimi parashkollor
	85.2		Arsimi fillor (cikli i parë i arsimit bazë)
	85.20	P8520	Arsimi fillor
	85.3		Arsimi mesëm
	85.31	P8531	Arsimi mesëm i përgjithshëm (klasat 7-8-9 të arsimit bazë + klasat 10-11-12 të gjimnazit)



	85.32	P8532	Arsim mesëm teknik dhe profesional
	85.4		Arsimi lartë
	85.41	P8541	Arsimi pas të mesmes jo i lartë
	85.42	P8542	Arsimi lartë
	85.5		Arsim tjetër
	85.51	P8551	Arsimi për sporte dhe argëtim
	85.52	P8552	Arsim kulturor
	85.53	P8553	Aktivite të shkollave të drejtimit të mjeteve
	85.59	P8559	Të tjera shkollime
	85.6		Shërbime arsimore mbështetëse
	85.60	P8560	Shërbime arsimore mbështetëse
Ndarja 86			Aktivite të shëndetit
	86.1		Aktivite të spitaleve
	86.10	Q8610	Aktivite të spitaleve
	86.2		Aktivite të mjekëve dhe dentistëve
	86.21	Q8621	Aktivite të mjekëve të përgjithshëm
	86.22	Q8622	Aktivite të mjekëve të specializuar
	86.23	Q8623	Aktivite të dentistëve
	86.9		Të tjera aktivite të shëndetit
	86.90	Q8690	Të tjera aktivite të shëndetit
Ndarja 87			Aktivite të qendrave të kujdesit mjekësor e social
	87.1		Aktivite të qendrave të kujdesit infermieror
	87.10	Q8710	Aktivite të qendrave të kujdesit infermieror
	87.2		Aktivite të qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike
	87.20	Q8720	Aktivite të qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike
	87.3		Aktivite qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit dhe personave me paaftësi
	87.30	Q8730	Aktivite qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit dhe personave me paaftësi
	87.9		Aktivite të qendrave të tjera kujdesit p.k.t
	87.90	Q8790	Aktivite të qendrave të tjera kujdesit p.k.t
Ndarja 88			Aktivite të kujdesit social pa akomodim
	88.1		Aktivite të kujdesit social pa akomodim për të moshuar dhe të paaftë
	88.10	Q8810	Aktivite të kujdesit social pa akomodim për të moshuar dhe të paaftë
	88.9		Të tjera aktivite të kujdesit social pa akomodim
	88.91	Q8891	Aktivite të kujdesit ditor të fëmijëve
	88.99	Q8899	Aktivite të tjera të kujdesit sociale pa akomodim p.k.t.
Ndarja 90			Aktivite krijuese, arte, dhe aktivite çlodhëse
	90.0		Aktivite krijuese, arte, dhe aktivite çlodhëse
	90.01	R9001	Shfaqje artistike



	90.02	R9002	Aktivitete mbështetëse për shfaqje artistike
	90.03	R9003	Krijimtari artistike
	90.04	R9004	Shfrytëzimi i strukturave dhe pajisjeve artistike
Ndarje 93			Aktivitete sportive, argëtuese dhe çlodhëse
	93.1		Aktivitete sportive
	93.11	R9311	Funksionimi i strukturave sportive
	93.12	R9312	Aktivitete të klubeve sportive
	93.13	R9313	Palestra
	93.19	R9319	Aktivitete të tjera sportive
	93.2		Të tjera aktivitete argëtuese dhe çlodhëse
	93.21	R9321	Aktivitete të parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar
	93.29	R9329	Aktivitete të tjera argëtimi dhe çlodhëse p.k.t.
Ndarja 96			Aktivitete të tjera shërbimi
	96.0		Aktivitete të tjera shërbimi
	96.04	S9604	Aktivitete të mirëmbajtjes trupore

**VENDIM****Nr. 754, datë 20.12.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 8.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar më 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në pikën 5, të vendimit nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a”, nënparagrafi “i”, emërtimi “ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” zëvendësohet me “ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit”.

2. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ b) 8 (tetë) anëtarë me status të përkohshëm, me mandat 2-vjeçar, nga shoqata e biznesit.”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 758, datë 20.12.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË AUTORITETIT KOMPETENT, PËR REALIZIMIN E RRITJES SË PËRGJITHSHME TË KAPITALIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BANKËN NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 2, të ligjit nr. 4/2023, “Për miratimin e rezolutave nr. 663, ‘Rritja e përgjithshme e kapitalit GCI’, dhe nr. 664, ‘Rritja selektive e kapitalit SCI’, të vitit 2018, të Këshillit të Guvernatorëve të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Autoriteti kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) (në vijim Banka) është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë autorizohet të komunikojë me Bankën për përcaktimin e dokumentacionit dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë plotëson dokumentacionin e kërkuar nga Banka dhe kryen pagesën, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Ministri i Drejtësisë, si pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga Banka, lëshon një dokument të titulluar “Memorandum i ligjit”, për të konfirmuar se janë ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për të përmbushur detyrimet që burojnë nga rritja e kapitalit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 759, datë 20.12.2023

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 581, DATË 31.8.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR, PËR TË NDËRMARRË PROCEDURAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP, PËR PROJEKTIN ‘PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË ÇELËSAVE PUBLIKË (PKI)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 581, datë 31.8.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor, për të ndërmarrë procedurat, për dhënien me koncesion/PPP, për projektin ‘Për ofrimin e shërbimit të infrastrukturës së çelësve publikë (PKI)’”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 760, datë 20.12.2023

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS (NR. ABA-P3, DATË 30 QERSHOR 2008), NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (TË ZËVENDËSUAR NGA AGJENCIA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR, NË TETOR 2008), PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9964, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën





e Madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Japonez

Nibancho, Godina Qendrore

5-25, Niban-cho, Chlyoda-ku, Tokyo 102-8012, Japoni

Datë: 10 maj 2023

Ref Nr. JICA (7R) 202305100001

Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr:3 Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sh.S. Z. Ervin Mete  
Ministre e Financave dhe Ekonomisë, Republika e Shqipërisë

**Marrëveshja e Huasë Nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008, për Projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve në Tiranën e Madhe”**

Në referencë të letrës suaj nr. 23442/4 prot. të datës 20 mars 2023 dhe Notës Verbale Nr. 024/2023, datë 19 prill 2023 të Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e cila duke shprehur pëlqimin e Qeverisë Japoneze për kërkesën e Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë, me anë të kësaj biem dakord si më poshtë:

1. Seksioni 2 (2) i Nenit I të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë, ndryshohet si më poshtë:  
“ Disbursimi përfundimtar sipas Marrëveshjes së Huasë do të kryhet jo më vonë se data 24 tetor 2026 dhe pas kësaj date nga ana e JICA-s nuk do të kryhet asnjë disbursim i mëtejshëm, përveç kur bihet dakord ndërmjet JICA-s dhe Huamarrësit.”
2. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data kur JICA njoftohet se kanë përfunduar procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huasë së lartpërmendur në Republikën e Shqipërisë.
3. Kjo letër nuk do të interpretohet për të autorizuar ndonjë ndryshim tjetër përveç atij të përmendur më lart.



Në momentin e përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë në Republikën e Shqipërisë, ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për amendimin e mësipërm duke nënshkruar atë dhe kopjen bashkëlidhur kësaj shkrese, duke ruajtur një kopje tuajën dhe duke na kthyer kopjen tjetër.

Me respekt,

Nga: Nënshkrimi  
MATSUNAGA Hideki  
Drejtor i Përgjithshëm,  
Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Evropës  
Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Japonez

Konfirmuar:

Në datën 08.11.2023

Për: MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga:.....  
MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

.....  
ERVIN METE

Në vëmendje të: Përfaqësuesit Kryesor, Zyra Ballkanike JICA



## VENDIM

Nr. 761, datë 20.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR. 165, DATË 21.3.2018,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
METODOLOGJINË E PROCESIT TË  
VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË  
KËRKIMORE-SHKENCORE TË  
NJËSIVE BAZË TË INSTITUCIONEVE  
TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtesa “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për arsimin ...”.

2. Në pikën 2, të kreut I, fjalët “... të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.” zëvendësohen me “... të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

3. Në pikën 4, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Nënndarjet “ii”, “iii”, “iv”, “v”, “vi”, të shkronjës “a”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ii. Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore;

iii. Lista e monografive të botuara në vendet e BE-së ose OECD-së dhe G-20-ës, të cilat përmbushin kushtet e origjinalitetit dhe janë vlerësuar në përmbajtje si punime shkencore nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe janë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit, ku është punësuar personeli akademik;

iv. Lista e monografive të botuara brenda vendit, të cilat janë vlerësuar në përmbajtje si punime shkencore nga, të paktën, 2 (dy) veta personel akademik, që i përkasin kategorisë “profesor” të fushës kërkimore-shkencore dhe janë pranuar nga

njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit, ku është punësuar personeli akademik;

v. Lista e librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës dhe të vlerësuar nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe janë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit, ku është punësuar personeli akademik;

vi. Lista e librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar brenda vendit dhe të vlerësuar nga, të paktën, 2 (dy) veta personel akademik, që i përkasin kategorisë “profesor” të fushës kërkimore-shkencore dhe janë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit, ku është punësuar personeli akademik.”.

b) Nënndarja “i”, e shkronjës “b”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Lista e patentave për shpikje të regjistruara pranë strukturës përgjegjëse për pronësinë industriale konform kuadrit ligjor në fuqi për patentat për shpikje.”;

c) Në shkronjën “c” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat akreditues të vendeve të tjera, anëtare nënshkruese të marrëveshjes së njohjes reciproke për fushat përkatëse.”;

ii. Pas nënndarjes “iv” shtohet nënndarja “v”, me këtë përmbajtje:

“v. Lista e bibliotekave të profilizuara elektronike.”;

ç) Nënndarjet “i”, “iv”, “vi”, “vii”, “viii” e “xi”, të shkronjës “ç”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“i. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, që i përket kategorisë “profesor”, “lektor” dhe “asistent lektor”, me kohë të plotë, në momentin e deklarimit;

iv. Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;

vi. Lista e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;



vii. Lista e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore të fituar nga personeli akademik i njësisë bazë;

viii. Lista e programeve të studimit “Master ekzekutiv”, “specializime afatgjata” dhe “Doktoratë”, që janë aktive në momentin e fillimit të periudhës 4-vjeçare të vlerësimit;

xi. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendase.”

d) Nënndarjet “i”, “ii”, “iii”, “iv”, të shkronjës “d”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

i. Lista e studimeve dhe e kërkimeve shkencore në 1 (një) disiplinë ose ndërdisiplinore, të aplikuara me partner të vendeve të OECD-së, BE-së dhe G-20-ës;

ii. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së, BE-së dhe G-20-ës;

iii. Lista e personelit të huaj akademik të punësuar pranë njësisë bazë në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë;

iv. Lista e programeve të përbashkëta të studimit në ciklin e dytë “Master i shkencave” dhe të ciklit të tretë me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së, BE-së dhe G-20-ës, që përfundojnë me lëshimin e një

diplome të përbashkët ose të dyfishtë apo të shumëfishtë.”.

4. Shkronja “a”, e pikës 1, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Të organizojë, të administrojë dhe të monitorojë procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet portalit “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në Shqipëri”.”.

5. Pika 1, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë krijohet platforma e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS, e cila shërben si bazë kombëtare të dhënash për kërkimin shkencor.”.

6. Pika 3, e kreut V, shfuqizohet.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**







*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8
-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë